

Teuta/ Mberrin ne Durres italiani Sorrentino

nga AlbaniaSoccer

E diel, 17 Nentor 2013 20:36



Italiani Sorrentino ka mberritur ne Durres. Te dielen ka qene ne stadiumin “Niko Dovana” ku ka pare ambientet qe skuadra perdor per tu stervitur. Ai gjithashtu eshte takuar me drejtuesit e klubit me te cilet ka biseduar per menyren e punes dhe cfare duhet bere ne vazhdim. Sorrentino i ka zene vendin Gugash Maganit i cili u shkarkua nga detyra per shkak te rezultateve jo te mira ne fundin e fazes se pare. Sorrentino pritet te sjelle nje fryme te re pune ne Durres dhe te jete pjese e nje projekti modern qe ka ne plan presidenti Edmond Hasanbelliu. Te henen italiani do te prezantohet perpara skuadres dhe mediave per te thene fjalen e tij te pare si trainer i Teutes.